



Deklarata e Zëvendësdirëtorit Menaxhues të FMN-së, Li në përfundim të vizitës së tij në Kosovë

PËR PUBLIKIM TË MENJËHERSHËM

Prishtinë, Kosovë – 22 shtator 2022: Z. Bo Li, Zëvendësdirëtor Menaxhues i Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN), lëshoi këtë deklaratë, sot në Prishtinë, në përmbyllje të vizitës së tij në Kosovë:

“Ishte kënaqësi ta vizitohet Kosovën si Zëvendësdirëtor Menaxhues i FMN-së. Dëshiroj t’i falënderoj autoritetet për mikpritjen e tyre të ngrohtë. Pata mundësinë që të mësoj më shumë për kushtet ekonomike dhe financiare të Kosovës, si dhe të riafirmoj përkushtimin e FMN-së ndaj Kosovës dhe për ta thelluar miqësinë tonë”.

“Unë largohem nga Kosova i inkurajuar nga takimet e hapura dhe konstruktive që kisha jo vetëm me qeverinë dhe autoritetet, por edhe me sektorin privat shumë dinamik dhe shoqërinë civile në vend, nga ku mora njohuri shumë të vlefshme, ndër të tjera, lidhur me mundësitë më të mëdha për të rinjtë dhe rolin më të madh të grave në ekonomi.

“Ekonomia e Kosovës ka treguar qëndrueshmëri të theksuar përballë tronditjeve si pasojë e pandemisë dhe rritjes së çmimeve të mallrave kohëve të fundit. Autoritetet u janë përgjigjur me shpejtësi këtyre tronditjeve, duke përfshirë një program shumë të suksesshëm vaksinimi që bëri të mundur vazhdimin e udhëtimeve të theksuara të diasporës qysh vitin e kaluar. Megjithatë, përdërisa dinamika e rimëkëmbjes nga viti i kaluar është ende e fortë, tronditja e çmimeve të energjisë e shkaktuar nga lufta në Ukrainë dhe kushtet më të shtrënguara financiare globale do të ndikojnë pashmangshëm kërkesën dhe aktivitetin ekonomik më 2022.”

“Në takimet me autoritetet dhe me përfaqësuesit e sektorit privat, diskutuam për sfidat afatshkurtra të Kosovës, përfshirë çmimet më të larta të ushqimit dhe energjisë, kushtet më të shtrënguara financiare globale dhe perspektivën më të zbehur të rritjes për Evropën dhe botën. Gjithashtu, diskutuam për sfidat afatgjata, si forcimi i mjedisit të punësimit dhe biznesit, si dhe rritja e efikasitetit dhe efektivitetit të buxhetit. Në takimet e mia theksova se mbajtja e politikave të shëndosha makroekonomike dhe stabilitetit financiar, forcimi i infrastrukturës arsimore, shëndetësore dhe ekonomike, me fokus më të madh në energji, si dhe avancimi i zbatimit të reformave strukturore janë elemente thelbësore për avancimin e potencialit për rritje ekonomike të Kosovës, tërheqjen e investimeve të huaja direkte, si dhe uljen e hendekut të të ardhurave me pjesën tjetër të Evropës”.

“Mirëpres vazhdimin e forcimit të marrëdhënieve tona me Kosovën dhe largohem me një sërë kujtimesh të bukura për vendin dhe popullin mikpritës të tij.”